

PRANUAR MË:

ACCEPTED ON:

PRIMLJENO:

Nr.No.Đi:

03.03.2023

02/125



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS

Kryesuesi i Kuvendit

Nr.02/_____

Datë: 01.03.2023

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 40 paragrafi 2 shkronja (d.), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/ 15, qeshor 2008", në bazë të nenit 10, nenit 19, nenit 29 paragrafi 1 pika a, të Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871 datë:12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e -II- (dytë) të rregullt të mbajtur me datë: 28.02.2023 merr këtë:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS TË KOMISIONIT KOMUNAL TË AKSIONARËVE PËR NDËRMARRJEN PUBLIKE "EKO-REGJIONI" SH.A, PRIZREN, NJËSIA NË MALISHEVË.

1. Miratohet Plani i punës nr.02.92 datë:15.02.2023 të Komsionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike "Eko-Regjioni" sh.a, njësia në Malishevë.
2. Plani i punës përfshinë gjithë punën dhe aktivitetet që do organizohen për vitin 2023 nga Komsioni Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike "Eko-Regjioni" sh.a, njësia në Malishevë.
3. Pjesë përbërse e këtij vendimi është Plani i punës të Komsionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike "Eko-Regjioni" sh.a, njësia në Malishevë.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kuvendi i Komunës, përmes Komsionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike "Eko-Regjioni" sh.a, njësia në Malishevë.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas dërgimit në auteritetin mbikqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin e Administrativ të Akteve të Komunave, dhe pas shpalljes në ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet :

MAPL-së

Arkivit të Komunës





Republika e Kosovës
Kuvendi i Komunës në Malishevë
Komisioni komunal i aksionarëve



DRAFT PLANI I PUNËS
Për vitin 2023



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA I KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS MALISHEVO
THE MUNICIPAL ASSEMBLY-MALISHEVO-SKUPSTINA OPSTINE MALISEVO



PRANUAR MË:

ACCEPTED ON:

PRIMLJENO:

Nr.Ne.Br.

15-02-2023

02/92

Duke u mbështetur në vendimin nr.02/368 të datës 12.08.2022 të Kuvendit Komunal në Malishevë për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike "Eko-Regjioni" sh.a, Prizren, njësia në Malishevë dhe në përputhje me ligjin për ndërmarrjet publike dhe ligjin për shoqëritë tregtare, kemi përgatitur draft planin e punës për vitin 2023.

Gjatë këtij viti ne si komision do të jemi të përkushtuar që ky plan (pas miratimit në kuvend) të jetë në funksion dhe në shërbim të përmirësimit të shërbimeve të cilat i ofron ndërmarrja publike Eko-Regjioni.

Komisioni Komunal i Aksionarëve përbëhet nga tre anëtarë : 1. Valon Mazreku, 2. Hamit Lima dhe 3. Valmir Gashi

Në këtë plan kemi paraqitur aktivitetet që do të realizohen gjatë këtij viti në mënyre kronologjike, si pas tabelës në vijim:

TABLEA E AKTIVITETEVE

Nr	Aktiviteti	Përiudha e realizimit	Qëllimi
1	Mbledhja e Komisionit Komunal të Aksionarëve: 1. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Komisionit Komunal të Aksionarëve për vitin 2023	Shkurt	Miratimi i planit të punës nga Komisioni Komunal i Aksionarëve

2	Mbledhja e Komisionit Komunal të Aksionarëve: 1. Takimi me zyrtarët e kompanisë, njësia në Malishevë. 2. Takim në zyren qendrore të kompanisë.	Mars	Informimi rreth kompanisë dhe përfaqësimi i komunës në bordin menaxhues të kompanisë. Plani investiv për Komunën e Malishevës.
3	Mbledhja e Komisionit Komunal të Aksionarëve: 1. Shqyrtimi i kriterëve dhe shpallja e konkursit për anëtarin e bordit menaxhues në kompani.	Mars	Hapja e konkursit për përzgjedhjen e anëtarit, i cili do të përfaqësojë Komunën në bordin menaxhues të kompanisë
4	Mbledhja e Komisionit Komunal të Aksionarëve: 1. Takim me Kryetarin e Komunës. 2. Zyrtarin për menaxhimin e mbeturinave	Mars	Informimi me gjendjen e Kompanisë Eko-Regjioni dhe shqyrtimi i mundësive për përmirësimin e shërbimeve si dhe përcaktimi i deponisë për grumbullimin e mbeturinave
5	Mbledhja e Komisionit Komunal të Aksionarëve: 1. Procedurat pas mbylljes së konkursit për anëtarin e bordit menaxhues në kompani.	Mars-Prill	Përzgjedhja e përfaqësuesit të Komunës në bordin menaxhues të Kompanisë sipas procedurave të rekrutimit.
6	Mbledhja e Komisionit Komunal të Aksionarëve: 1. Takim me Drejtorinë e shërbimeve publike. 2. Takim me Drejtorin e Inspektoriatit.	Prill-Maj	Informimi rreth kontratës së Komunës dhe Kompanisë për kryerjen e shërbimeve për institucionet publike. Informimi për respektimin e orarit për mbledhjen e mbeturinave.
7	Mbledhja e Komisionit Komunal të Aksionarëve: 1. Vizita në terren dhe takimi me përfaqësues të fshatërave	Maj-Qershor	Informimi nga kryetarët e fshatërave rreth gjendjes së pastërtisë dhe respektimit të orarit për mbledhjen e mbeturinave.
8	Mbledhja e Komisionit Komunal të Aksionarëve: 1. Prezantimi i gjendjes së pastërtisë pas vizitave në terren dhe takimi me përfaqësues të fshatërave	Shtator	Raporti i gjendjes rreth menaxhimit të mbeturinave si dhe deponit ilegale të mbeturinave
9	Mbledhja e Komisionit Komunal të Aksionarëve: 1. Takim me Kryetarin e Komunës.	Tetor	Informimi me gjendjen e pastërtisë në Komunë si dhe menaxhimi i mbeturinave

10	Mbledhja e Komisionit Komunal të Aksionarëve: 1. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës të Komisionit Komunal të Aksionarëve. 2. Hartimi i planit të punës për vitin 2023.	Dhjetor	Shqyrtimi i raportit të punës së komisionit për gjendjen e kompanisë, sfidat, plani investiv i kompanisë dhe shqyrtimi i mundësive për ngritjen e kapacitetave të kompanisë në kryrjen e shërbimeve.
11	Raportimi i Komisionit Komunal të Aksionarëve në Kuvend.	Dhjetor	Raportimi i Komisionit Komunal të Aksionarëve në kuvend rreth gjendjes së kompanisë.

Datë: 19.01.2023

Malishevë

Kryesuesi i Komisionit Komunal të Aksionarëve

